



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:175434  
Datë: 25.04.2024  
Numri i dokumentit: 05622834

**PA1.nr.306/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Mehmet Ndrecaj - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B. N. , nga P, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.4 lidhur me par.6, të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar H. Z. - av. R. B., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.907/23, datë 22.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 25.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit autorizuar të palës së dëmtuar H. Z. - av. R. B., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.907/23, datë 22.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin, P.nr.907/23, datë 22.11.2023, të akuzuarin B. N. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.4 lidhur me par.6, të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj burgim, të cilin dënim konform nenit 44 të KPRK-së, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit, gjykata e ka zëvendësuar me 900 (nëntëqind) € gjobë, të cilën shumë i

akuzuari është i obliguar që ta paguaj brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj, atëherë gjykata në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë në shumë prej 900 (nëntëqind) € gjobë, do ta zëvendësoj me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve. Është obliguar i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) €, në emër të ekspertizës së komunikacionit rrugor shumë prej 100 (njëqind) €, në emër të ekspertizës mjeko- ligjore shumë prej 20 (njëzet) € dhe në emër të Fondit për Mbrojtjen e Viktimave shumë prej 30 (tridhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :**

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar H. Z. av. R. B., , për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa të aprovohet, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptohet një dënim më i rëndë ose lënda të priset dhe çështja t i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit B. N. av. A. Q. , me propozim që ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.316/2024, të datës 26.02.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit të i shqiptohet dënim më i rëndë.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

### **- Ankesa është e pabazuar.**

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, mirëpo kolegji penal i kësaj gjykate pretendimet e lartcekura i hodhi si të palejuar pasi që me dispozitën e nenit 381 par 3 edhe pse i dëmtuari ka të drejtë ankese për këtë vepër penale por se ka të drejt vetëm për sa i përket vendimit mbi dënimin e jo edhe për bazat tjera ankimore siç pa të drejt ka bër përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, andaj kolegji penal i kësaj gjykate pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar sa përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit i hodhi si të palejuara. Megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se

aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimin të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar H. Z. av. R. B., e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit për dënimin, duke pretenduar që gjykata lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin, gjykata e ka konsideruar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë dhe sjelljen korrekte të të akuzuarit. Sipas deklaratës së të dëmtuarës dhënë në prokurori , e njëjta ka deklaruar se sipas dëshmitarëve që kanë përcjell momentin e ndodhjes së aksidentit i akuzuari pas aksidentit ka ikur nga vendi i ngjarjes dhe nuk i ka dhënë ndihmën e nevojshme të dëmtuarës, ndihma e parë i është dhënë nga personat e tretë të panjohur. Nga momenti i aksidentit asnjëherë nuk ka kontaktuar pas rastit me të dëmtuarën. Ky fakt nga vet e dëmtuara nuk është marrë si rrethanë rënduese. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa të aprovohet, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptohet një dënim më i rëndë ose lënda të prishet dhe çështja t i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, për shqiptimin e dënimit më të rëndë, ndaj të akuzuarit, është e pabazuar. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të rëndë, ndaj të akuzuarit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarve e duke u bazuar konform të dispozitës së nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata si rrethanë lehtësuese morri pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe sjelljen e tij korrekte, ndërsa rrethanë rënduese natyrën dhe llojin e veprës penale. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e përfaqësuesit autorizuar të palës së dëmtuar, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit të i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që akuzuarit të i shqiptoj dënim më të rëndë, sikurse që pretendohet në ankesë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë

shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

### **Departamenti i Përgjithshëm**

PA1.nr.306/24, më datë 25.04.2024

**Zyrtarja ligjore;**

Rrezarta Bala

**Kryetari i kolegjit**

Abdullah Ahmeti

**Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani

Mehmet Ndrecaj